

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Lin Yi International Investments Co., Ltd, me seli të regjistruar në 15 F., nr. 207-1, pjesa 3 Beixin Rd., Xindian Dist., New Taipei City 231030, Tajvan dhe Mitsubishi Fuso Truck and Bus Corporation, me seli të regjistruar në 10 Ohkura-cho, Nakahara-ku Kawasaki-shi, Kanagawa, 211-8522 Japoni, të dorëzuar përmes Filip Zafirovskit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 06.05.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin shoqëritë Lin Yi International Investments Co., Ltd, me seli të regjistruar në 15 F., nr. 207-1, pjesa 3 Beixin Rd., Xindian Dist., New Taipei City 231030, Tajvan dhe Mitsubishi Fuso Truck and Bus Corporation, me seli të regjistruar në 10 Ohkura-cho, Nakahara-ku Kawasaki-shi, Kanagawa, 211-8522 Japoni, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Mitsubishi Fuso Bus Manufacturing Co. Ltd., me seli të regjistruar në 1 Dojo, Fuchu-machi Toyama-shi, Toyama, 939-2757, Japoni, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 24.03.2026, e plotësuar më 15.04.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga shoqëritë Lin Yi International Investments Co., Ltd, me seli të regjistruar në 15 F., nr. 207-1, pjesa 3 Beixin Rd., Xindian Dist., New Taipei City 231030, Tajvan dhe Mitsubishi Fuso Truck and Bus Corporation, me seli të regjistruar në 10 Ohkura-cho, Nakahara-ku Kawasaki-shi, Kanagawa, 211-8522 Japoni, me të cilin Lin Yi International Investments Co., Ltd dhe Mitsubishi Fuso Truck and Bus Corporation do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Mitsubishi Fuso Bus Manufacturing Co. Ltd., me seli të regjistruar në 1 Dojo, Fuchu-machi Toyama-shi, Toyama, 939-2757, Japoni.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe dokumentacionit bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

-**Mitsubishi Fuso Truck and Bus Corporation** (MFTBC) është prodhues dhe furnizues me shumicë i kamionëve të lehtë dhe të rëndë, si dhe i autobusëve nën markën Fuso, për përdorime të ndryshme. Sa i përket autobusëve, MFTBC furnizon autobusë të lehtë dhe të rëndë në Japoni dhe autobusë të lehtë në nivel global, kryesisht përmes aktiviteteve që do të transferohen te shoqëria e synuar – Mitsubishi Fuso Bus Manufacturing Co. Ltd.. MFTBC gjithashtu prodhon pjesë rezervë përkatëse dhe motorë industrialë.

Në lidhje me prodhimin e autobusëve, MFTBC:

-Prodhon dhe furnizon (me shumicë dhe pakicë) në Japoni vetëm autobusët e mëposhtëm të rëndë: Aero Queen, Aero Ace dhe Aero Star, në kategoritë e autobusëve urbanë dhe autobusëve turistikë; dhe

-Prodhon dhe furnizon (me shumicë dhe pakicë) në Japoni dhe (me shumicë) në tregjet ndërkombëtare autobusë të lehtë: modeli Rosa (5,2 deri në 6,3 tonë me kapacitet ulësesh për 25 deri në 33 pasagjerë, i projektuar për transport të përgjithshëm të udhëtarëve, transport shkollor dhe transport special) dhe modeli BA (i cili nuk është pjesë e transaksionit).

MFTBC zhvillon dhe prodhon një gamë motorësh industrialë për përdorime të ndryshme, duke përfshirë përdorimin jashtë rrugëve publike, si ekskavatorë, vinça, gjeneratorë energjie, traktorë kopshtarie dhe pirunë ngritës. MFTBC aktualisht nuk prodhon dhe nuk furnizon autobusë me emision zero (ZEV).

MFTBC është shoqëri private, në pronësi shumicë dhe nën kontroll të vetëm të Daimler Truck AG¹ (DTAG) (89,29%). DTAG është korporatë aktive në biznesin e kamionëve dhe autobusëve, e fokusuar në prodhimin dhe shitjen e tyre. Gama e produkteve të DTAG për kamionë përfshin kamionë të lehtë, të mesëm dhe të rëndë për distanca të gjata, shpërndarje dhe transport në kantierë ndërtimi, si dhe automjete speciale që përdoren kryesisht në veprimtari komunale.

DTAG nuk kontrollon asnjë shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut, ndërsa produktet e saj shpërndahen nga një distributor i pavarur – palë e tretë e grupacionit Daimler në Maqedoninë e Veriut, shoqëria Mak Autostar SHPKNJP Shkup.

-**Lin Yi International Investments Co., Ltd** (LYIC) është shoqëri investuese në pronësi të Hon Hai Precision Industry Co., Ltd., e themeluar në vitin 1974 në Tajvan. Hon Hai Precision Industry Co., Ltd., e cila vepron nën emrin Foxconn, së bashku me subjektet që kontrollojnë (“Grupacioni Foxconn”), është prodhues global i elektronikës dhe furnizues kryesor i zgjidhjeve teknologjike. Ajo ofron shërbime të prodhimit elektronik në segmentet e mëposhtme: elektronikë inteligjente për konsum të gjerë, cloud dhe rrjete, kompjuterë, si dhe komponentë elektronikë dhe produkte të tjera.

Grupi Foxconn nuk ka shoqëri të varura, degë apo përfaqësi të inkuorporuara në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

¹ Daimler Truck AG është 100% në pronësi të Daimler Truck Holding AG, e cila është e listuar në Bursën e Frankfurtit.

-Mitsubishi Fuso Bus Manufacturing Co. Ltd. (MFBM) aktualisht është shoqëri e varur në pronësi të plotë të MFTBC. Ajo do të merret me zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e autobusëve. Për këtë qëllim, para përfundimit të transaksionit të propozuar, MFTBC do të transferojë brenda grupit aktivitet, detyrimet, kontratat dhe të drejtat e detyrimet e tjera që posedon MFTBC vetëm në lidhje me biznesin e autobusëve (që nënkupton zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e autobusëve, me përjashtim të furnizimit me pjesë, shitjes ndërkombëtare dhe shërbimeve pas shitjes).

Mitsubishi Fuso Bus Manufacturing Co. Ltd. nuk ka prani apo aktivitete në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ